



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY



03-03/DPK  
03  
18-08-2016  
01-2728/16

DATË/A:	18.08.2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP 03-03/2366/16
PËR/ZA/TO:	z. Afrim BAJRAKTARI, Drejtor i Zyrës së Prokurimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"
CC:	z. Esat KELMENDI, Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizim me Pajisje laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevoja të UP-së (Lot 1) "

*I nderuari z. BAJRAKTARI,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevoja të UP-së (Lot 1) " me numër prokurimi 90400-16-022-111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevoja të UP-së (Lot 1)" me numër prokurimi 90400-16-022-111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

## *Arsyetimi*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia) me datë 21.07.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-2366/16*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevoja të UP-së (Lot 1)*" me numër prokurimi *90400-16-022-111*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Agjencia me datë 21.07.2016, ka paraqitur kërkesë për dokumentacion, ku ka kërkuar nga Autoriteti në fjalë që ta dorëzoj në Agjenci, dokumentacionin përkatës për këtë procedurë të prokurimit, pasi Autoriteti kontraktues të përfundoj procesin e vlerësimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues me datë 27.07.2016 ka ofruar tërë dokumentacionin e kërkuar nga Agjencia.

Agjencia duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit dhe pas shqyrtimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim: Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 12.05.2016, ku për këtë aktivitet të prokurimit, Autoriteti kontraktues ka paraparë procedurën e hapur, kontratë të llojit furnizim me vlerë të madhe të cilën e ka ndarë në 8 lote (pjesë).

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 37 Operator ekonomik ndërsa ofertat vetëm për lot 1 i kanë dorëzuar 5 prej tyre.

### ***Shkeljet ligjore gjatë hartimit të Specifikimeve teknike***

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, tek lot 1 Autoriteti kontraktues ka kërkuar që të furnizohet me pajisje laboratorike për të gjitha Departamentet e FSHMN-së. Agjencia pasi ka analizuar kërkesën e njësisë kërkuese dhe dosjen e këtij tenderi, konstaton se tek lot 1 artikulli 1 është kërkuar Atomic Absorber me përshkrimet teknike si në vijim:

ContrAA (R) 300 flame technique, hybride technique/Monochromator, Eschelle double monochromator, premonochromator with quartz prism/ Wavelength range-185-900nm/ Spectral range-2pm/200nm, Detector CCD array with high quantum efficiency and increased UV sensitivity, lamp Xe optimized hot- spotmode, simultaneous drift correction, Burner nebulizer system Wide slit profile automatic cleaning device for 5 cm burner head, dimensions:800 mm\*650 mm\* 700 mm, Weight: 90 kg. Tek artikulli 2 është kërkuar Microwave digestion system janë përshkruar specifikimet teknike si në vijim: +8 digestion vessels Power supply:230 V/50/60 Hz/2300 W, Optional 200 V/50/60 Hz/2300W, Microwave power 1450 W, adjustable in 1% steps, Frequency: 2450 Hz controller interfaces: Ethernet, USB and RS 232, language software: English, Croatian, German, French etc. Internal diagnostics: Magnetron status, magnetron temperature, oven temperature, transformer, cover lock temperature measurement:80-300 OC, precision 10c to 200 OC pressure measurement (option):0-150 bar, precision 5 bar, rotary table approx.6 RPM, Vessels:8.

Tek artikulli 3 është kërkuar Spectrophotometer me përshkrimet si në vijim: Reflectance Wavelength range: 190-1100 nm spectral bandwidth: variable 0.2/0.5/1/2/4 nm, fix 1.4 nm scanning speed 12000 nm/min 1.

Specifikimet teknike që duhet t'i kenë këto pajisje laboratorike tek lot 1 janë specifikuar nga njësia kërkuuese në atë mënyrë që i përshtatën vetëm prodhuesit *Analytikjena* dhe eliminojnë prodhuesit tjerë. Duke vepruar në këtë mënyrë Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe 28 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik.

**Shqetësuese për Agjencinë mbetet fakti që si pasojë e hartimit të Specifikimeve teknike diskriminuese ka ardhur në shprehje të rekomandohet për kontratë Operatori ekonomik i cili ka ofertuar me çmimin më të lartë.**

Autoriteti kontraktues më konkretisht Njësia Kërkuuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të mos jenë me vlera fikse, por të caktohet minimumi i kërkesave teknike dhe që të jenë të hapura për të gjithë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet e tilla. Autoriteti kontraktues e ka të ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik apo prodhues.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimin e kënaqshëm me pajisje të tilla.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, dhe nenin 28 Specifikimet teknike i Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e lot 1 dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

***Me respekt !***